


COVID 19. REFLEKTIME

FLORIE HAXHIAJ

Viti II, Financë Bankë-Kontabilitet, UMSH



Në momentin e parë kur nisa të shkruaj një reflektim për Covid-19 gjithcka që më erdhi në mendje ishte maska, rrugë të zbrazura, izolim, e panjohur, frikë, pamundësi dhe luftë me një armik mikroskopik ndërkohë që po ti mbledhësh të gjitha krijohet një skene e filmave të Hollywood-it, e paperceptueshme për realitetin. E gjithë kjo duket si një ëndërr e keqe e cila vazhdon dhe ndiqet nga zhvillimet tragjike çdo ditë në sfond. Kur dëgjova për herë të parë rreth Covid-19, nuk e imagjinoja që ky armik i padukshëm do mund të gjunjëzonte gjithë botën e shek.XXI. Është ironike të mendosh se si kjo botë kaq e zhvilluar në fushën e shkencës, mjekësisë e teknologjisë, është kaq e pafuqishme duke urdhëruar dhe udhëzuar në izolimin e vetëvetes, mbylljen në lëvizshmëri të saj, në pritje që çdo gjë të kalojë. E gjitha kjo duket si një ndëshkim i merituar për vetshpalljen si zotër të gjithçkaje.

Muaji mars hapi një faqe të re për Shqipërinë tonë të vogël duke na mbushur me dhimbje dhe keqardhje për rastet e infektive dhe humbjet e jetëve. Çdo ditë na shoqëronin numrat e rasteve që shtoheshin duke na ngjallur frikë, pasiguri dhe stres. Ditët kalojnë të kushtëzuara brenda mureve të shtëpisë, ku secili zgjedh të vijojë rutinën e tij brenda “kështjellës” së dezinfektuar, duke shmangur prezantuesit e lamjeve teksa raportojnë raste të reja të prekurish apo viktimash. Për ne studentët, mësimi online sistematik na ka ndihmuar për tu shkëputur nga realiteti anormal që ndodh jashtë dyerve.

“Nese sëmundja është një shprehje e jetës vetjake në rrethana të pafavorshme, atëherë epidemitë janë tregues i çrregullimeve të popullatës” - Rudolf Virchov. Kjo është absolutisht e vërtetë! Ne nuk po arrijmë të vlerësojmë sic duhet favorin “më shumë kohë për familjen dhe për veten”, të cilin e kërkojmë me ngulm në ditët e ngarkura. Shqetësimi i njerëzve për izolimin është i pavend në raport me dhimbjen që të jep perballja me sëmundjen. Është zgjedhje e vështirë të luftosh në frontin e parë jo vetëm për ata, por edhe për familjet e tyre. Duke falënderuar nga zemra mjekët për sakrificën e tyre dua të ndaj me ju një copëz nga jeta ime. Jam fëmija e një personeli mjekësor, luftoj çdo ditë me frikën e infektimit, me aromën e alkoolit që vjen nga duart dhe rrobat e dizinfektuara që më ngrijnë dhe më mbajnë larg ngrohtësisë së një përfaqimi. Luftoj që kjo frikë të mos mposhti ndjenjën e krenarisë që ndjej për sakrificën e prindit tim. Mundohem të bind ndërgjegjen të pranohet se dikush duhet ta bëjë këtë, dikush duhet të rrezikojë atje jashtë për ti shpëtuar ata njerëz.

Sigurisht që dielli do të lind sërish për mua, për ty, për prindërit dhe njerëzit tanë! Le të shërbejë kjo kohë brenda së cilës kemi ngecur, si reflektim për të shkuarën e mbushur me momente që nuk ju dhamë rëndësinë e duhur, duke i marrë si të mirëqena dhe në këtë të tashme të ngrirë ti premtojmë vetes se shëndeti, koha dhe njerëzit e dashur duhen vlerësuar kur i ke, pra TANI